

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për praninë për shqyrtim të kërkesës nr. 05 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerzore të Bashkisë Durrës"

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S'ka prezent

Z. K. Bele: Atëherë, fillojmë me seancën publike të KAS-it për të verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes, referuar kërkesës nr. 05 të KSHZ-së me objekt "Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore". Relator sipas shortit jam zgjedhur une Koli Bele. Të pranishëm janë anëtarët e KAS-it dhe aministrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi shtesë. Palë të tjera nuk kemi të pranishme. Në këtë fazë do të ecim me verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes 124,126,129 të Kodit Zgjedhor. Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të bëjë një përshkrim të shkurtër si dhe të shpjegojë qëndrimin e tij lidhur me këtë rast, si dhe çfarë mendon se është relevantete duke qenë se në kujtesën time, të më korrigjojnë shokët, kolegët, kjo është praktika e parë ku ne ecim për vendosjen e këtyre sanksioneve.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

Z. Y. Merkaj: Gjatë periudhës 20-23 janar 2023 Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e KQZ-së 2 veprimtari të cilat janë jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në përfundim të procesit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se këto veprimtari të ndërmara nga Bashkia Durrës përbëjnë veprimtari publike dhe ka shkelur detyrimin ligjor për mosraportimin e këtyre veprimtarive brenda afatit ligjor. Në këto kushte Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative të vendosjes së gjobës për personin përgjegjës, i cili ka detyrimin të bëjë raportimin. Bashkëlidhur kemi dhe vendimin nr. 45 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka bërë propozimin, si dhe shkresën nr. 461 për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare në procesin administrativ. Nga verifikimi i kërkesës së Komisionerit, e plotëson anën formale dhe përmbajtjen e kërkesës, pasi ka emrin e plotë të subjektit zgjedhor ose subjektit që bën ankesën dhe krijimin e vendimit të çështjes ankimore, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër të çështjes së pretenduar dhe përshkrimin e fakteve, argumentave , dispozitave ligjore tek të cilat mbështetet kërkesa, kemi provat që janë kërkuar gjatë procesit të shqyrtimit, si dhe datën dhe firmën e kërkuarit që kërkon marrjen e masës administrative. I plotëson kërkesat e nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

Z. K. Bele: Në fakt unë kam një pyetje, duke qenë se jam relator edhe në një rast tjetër, unë shoh se këtu është propozuar Drejtori i Burimeve Njerësore, në një rast tjetër Sekretar i Përgjithshëm ku jeni bazuar që keni konkluduar që është personi “x” apo “y”.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëherë, 4 muaj para, bazuar në vendimin nr. 9, Komisioni Qendror të Zgjedhjeve i ka dërguar shkresë të gjitha institucioneve për të vendosur personin e konaktit, i cili është përgjegjës për të raportuar veprimtaritë e ndaluara. Në disa raste titullari i institucionit ka vendosur Drejtorin e Përgjithshëm, në raste të tjera ka vendosur Sekretarin e Përgjithshëm. Duke ju referuar dhe kërkesës dhe autorizimit që ka dhënë titullari i institucionit, kemi bërë edhe marrjen e masës administrative për personin përgjegjës. Në rastin konkret ka qenë Drejtori i Burimeve Njerëzore, për Bashkinë Durrës. Në disa raste të tjera, tek Bashkia Roskovec është Sekretari i Përgjithshëm, faleminderit.

Z. K. Bele: Pra praktika e KQZ-së ka ecur me parimin se ai që dizenjohet si personi përgjegjës, ai do të jetë përgjegjësi për raportimet e shkeljeve rast pas rasti. Nga shikimi që i kam bërë materialit se çfarë është thënë në seancë, duket sikur sanksioni ka të bëjë vetëm me faktin e mosraportimit brenda afatit ose para afatit 5 ditor. Pra ky është rasti në tipologjinë e këtyre shkeljeve, pra nuk i kemi hyrë natyrës së aktivitetit, vetëm raportimit 5 ditor, pra ky e ka bërë 2 ditë, në vend që ta bënte 5 ditë.

Z. Y. Merkaj: Ideja është që është marrë gjatë shqyrtimit, është apo jo veprimtari publike, pastaj është raportuar apo jo. Pasi është konstatuar që është veprimtari publike që është raportuar jashtë afatit, atëherë është marrë propozimi për vendosjen e masës së gjobës.

Z. K. Bele: Po mirë a kishte mekanizëm KQZ-ja që ta ndalonte veprimtarinë? Që ta kuptojmë, është Bashkia e Durrësit, unë jam përfaqësuesi i Bashkisë së Durrësit. Kam patur detyrimin të raportoj 5 ditë para. Në këtë fazë, përpara se të shkosh tek

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

sanksioni, nuk mund të ndalohet? Kjo është veprimtari e ndaluar, nuk ka për të ndodhur sepse nuk është raportuar.

Z. Y. Merkaj: Duke marrë vendimin nr. 9, dt. 24.12.2020, KQZ-ja nuk është institucioni që vendos është e ndaluar apo nuk është e ndaluar. Pasi bëhet shkelja, atëherë e konstaton këtë shkelje. Nuk e parandalon.

Z. K. Bele: Pra nuk ka mekanizëm KQZ-ja që ta ndalojë, vetëm e sanksionon kur shkelja ka ndodhur. Dakord, mirë faleminderit. Nga kolegët kush ka pyetje?

Z. L. Braho: Ylli këtu janë disa prova. Duhet të jenë në sistem besoj. Unë nuk e kam të qartë. Kjo, është dhe një tjetër e ngjashme me këtë. Këto janë nga portali i KQZ-së?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. L. Braho: Po tani këto tek pyetjet me pjesëmarrjen e medias thonë jo, i hapur për publikun jo, kjo është me vetëdeklarim, pra çfarë deklarojnë ata. Por këtu pastaj, tek kjo del që postimi është shfaqur në faqen personale të titullarit. Ju jeni nisur nga postimi apo jeni nisur nga raportimi që këta kanë bërë? Që ka filluar hetimi administrativ.

Z. Y. Merkaj: Atëherë në fokus ka qënë thjesht vetëm afati i raportimit.

Z. K. Bele: Atëherë, nëqoftëse veprimtaria nuk bie në kategorinë e përcaktuar nga neni 92, pika 2 që thotë “Veprimtaria duhet të jetë e hapur për publikun, me qëllim

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

informimin”. Pra edhe nëse bashkia raporton një veprimtari, por nuk është publike, a mund ta sanksionojmë ne për mosraportim në afat?

Z. L. Braho: Ose më saktë, kur nuk është publike duhet ta raportojnë?

Z. K. Bele: Se këta vet këtu thonë që nuk është as publike dhe pa pjesëmarrjen e medias, por përse e kanë raportuar, këtë nuk kuptoj.

Z. Y. Merkaj: Supozoj sepse mund të shikojnë edhe rrjetet sociale, adresat e titullarëve që promovojnë dhe bëjnë fushatë për zgjedhjen e Bashkisë.

Z. K. Bele: Pra neni 92, pika 2 që ta lexojmë thotë...

Z. L. Braho: Thotë “Raportimi në këtë faqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose aktivitetit publik”. Pra kur është publike. Tani unë nuk e kuptoj.

Z. K. Bele: Neni 192, pika 2 “Të gjitha veprimtaritë me karakter publik deri në datën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike, të gjitha veprimtaritë që janë të hapura nga pjesmarrja e publikut si dhe që kanë axhendë informimi”. Tani kur një veprimtari nuk është e hapur për publikun dhe median, nuk ka axhendë informimi. A duhet të hetojmë? Pyetja është. A është veprimtari publike kur ai thotë nuk është e hapur për publikun?

Z. L. Braho: Ose më saktë, ka ndryshuar qëndrim Komisioneri në rastin e postimeve në facebook?

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

Z. Y. Merkaj: Atëherë, tek arsyetimi i vendimit të Komisionerit, tek kërkesa që i ka drejtuar KAS-it, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar që kjo veprimtari është veprimtari publike. Kështu ka dalë gjatë shqyrtimit administrativ. Tek faqja e dytë e kërkesës tek paragrafi i dytë.

Z. K. Bele: Kam unë një pyetje, meqe jemi tek seanca e plotësimit të elementëve të formës dhe të përmbajtjes. Sipas ligjit sanksionet i vendos KAS-i, sipas Kodit Zgjedhor. Sipas vendmit nr. 9 të Komisionit Rregullator ka një pikë aty që cakton që në këto raste i vendos gjobat Komisioneri. Si e ka zgjidhur administrata këtë ngërç po e quaj.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, në të gjitha kërkesat që ka bërë Komisioneri, e ka vlerësuar këtë kompetencë të KAS-it dhe ka bërë vetëm propozimin për marrjen e masës administrative.

Z. K. Bele: Domethënë ai vendimi i Rregullatorit do të rrijë ashtu apo do të ndryshojë në të ardhmën? Si do të zgjidhet kjo...

Z. Y. Merkaj: Tani iniciativa ka dhe pritet që ta ndryshojmë, mirëpo jemi në proces zgjedhor dhe jemi shumë të ngarkuar. Ndoshta pas datës 14 maj. Ose më parë, nuk mund të jap... Është afati i raportimit i ndryshën, prandaj janë dy kërkesa për ndryshim.

Z. K. Bele: Atëherë, KAS i konsultuar në vend, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura, vendosi kalimin e çështjes për në seancë, duke caktuar si afat datën 28.02.2023, ora 12:30. Të merren masa për njoftimin e palëve. Me kaq e mbylлим seancën. Faleminderit!

Vendimi nr. 8

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

**27.02.2023
Ora 12:27**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për pranim për shqyrtim të kërkesës nr. 06 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Berat””.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

Të tjerë: S’ka prezent

Z. E. Çefa: Atëhere, çelim seancën për vlerësimin paraprak të kërkesës nr.6 të Komisionerit, i cili propozon vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë për zonjën Arisa Toska Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Berat. Verifikojmë prezencën është paraqitur Sekretari i Përgjithshëm i cili pëfaqëson Komisionerin në këtë hetim administrativ. KAS-i është i plotë dhe ka kourum për të vijuar shqyrtimin. Meqënëse jemi në vlerësimin e kritereve paraprake për kalimin në shqyrtim të kësaj kërkesë ia jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të parashtrorjës shkurtimisht shkaqet dhe argumentet e Komisionerit në këtë propozim për KAS.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Gjatë periudhës 20 Janar dhe 23 Janar në ndërfaqen e KQZ-së janë raportuar gjithësej 45 aktivitete ndër të cilat dy aktivitete të Bashkisë Berat, të cilat janë aktivitete të raportuara jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 92 pika 2 e Kodit Zgjedhor. Nisur nga tematika e këtyre aktiviteteve dhe nga

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

shqyrtimi administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor për mos raportimin brenda afatit ligjor të përcaktuar në ligj. Në këto rrethana Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative me gjobë në masën 10 mijë lekë për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Berat, si personi përgjegjës i cili duhet të raportonte këto veprimtari.

Z. E. Çefa: Ndonjë pyetje, ndonjë koment nga kolegët? Atëhere, nga vlerësimi paraprak unë konsiderojë që çështja i plotëson elementët e nenit 130 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa është në kompetencën e KAS-it, sigurisht Komisioneri ka legjitimitet në paraqitjen e kësaj kësaj kërkesë, këtij propozimi përpara KAS. Ka respektuar dhe afatet ligjore, kështu që propozoj kalimin në seancë shqyrtimi e cila do të zhvillohet nesër në orën 12 e 45. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 9

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

27.02.2023

Ora 12:29

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për pranim për shqyrtim të kërkesës nr. 07 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zotit Martin Dodi, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Fier””.


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S’ka prezent

Z. I. Rusmali: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës nr.7 për të cilën unë jam caktuar relator. Komisioneri me këtë kërkesë ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Martin Dodi Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Fier. Për shkak se ka raportuar dy veprimtari publike, sanksioni është për dy veprimtari publike në një afat më të shkurtër se afati 5 ditor që parashikon ligji. Pala e interesuar nuk është e paraqitur në këtë seancë shqyrtimi paraprak, është i paraqitur Sekretari i Përgjithshëm në emër të Komisionerit. Kolegët ndonjë deklaram për papajtueshmëri, për konflikt me Martin Dodin nuk e njihni?! Në rregull atëhere, nuk ka pengesa për trupën për të shqyrtuar çështjen. Ia jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm për ta prezantuar shkurtimisht.

Z. Y. Merkaj: Gjatë periudhës 24 Janar -2 Shkurt 2023 në ndërfaqen e veprimtarisë së ndaluara publike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë raportuar 324 aktivitete ndër të cilat dhe 7 veprimtari të Bashkisë Fier të cilat janë

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*


raportuar jashtë afatit ligjor parashikuar nga neni 92 pika 2 e Kodit Zgjedhor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar se këto veprimtari janë veprimtari të raportuara dhe janë veprimtari publike dhe Bashkia Fier ka shkelur detyrimin ligjor për mos raportimin brenda afatit të përcaktuar. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar KAS-it marrjen e masave administrative me gjobë në masën 10 mijë lek për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Fier. Nga verifikimi paraprakë i kërkesës së Komisionerit konstatohet se ajo plotëson elementët e formës dhe të përmbatjes së parashikuar në nenin 126 të Kodit Zgjedhor dhe 130 pasi është kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit në rastin konkret e kërkesës. Është KAS legjitimimi i ankuesit dhe kërkuesit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për propozimin për gjobë si dhe respektimin e afatit ligjor të kërkesës është brenda afatit. Ju faleminderit.

Z. I. Rusmali: Mirë, faleminderit! Komisioneri ka zhvilluar hetim administrativ për kërkesën dhe kërkesa vjën në përfundim të hetimit administrativ. Kështu që nga kjo pikëpamje rrethanat ligjore plotësohen për ti hapur rrugë shqyrtimit nga ana e KAS-it. Ajo që ndoshta mungon në praktikën tonë, ekstrakt nga raportimi për veprimtarinë e parë dhe të dytë? Se ne kemi titullin e veprimtarisë po kanë të dhënat elementët përbërës të raportimit se ato duhet të kenë element përbërës të raportimit.

Z. Y. Merkaç: Patjetër i kemi.

Z. I. Rusmali: Siç janë rastet e tjera. Mund ti sigurojmë këto njëherë për shqyrtimin?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

Z. Y. Merkaj: Patjetër!

Z. I. Rusmali: Në rregull. Ndonjë pyetje, ndonjë diskutim nga kolegët?

Z. L. Braho: Është për shqyrtimin në themel për llogaritjen e pjesës së afatit se këtu del për këto aktivitet që nuk është kërkuar sanksioni. Është raportuar me datë 31 dhe data e zhvillimit ka qenë data 4. Si e konsideroni këtë 5 ditëshin pra numërohet edhe dita e raportimit? Ky qëndrim është mbajtur?

Z. Y. Merkaj: Po, është përfshirë në numërim edhe data 31 e raportimit.

Z. L. Braho: Në rregull.

Z. I. Rusmali: Jemi në rregull me raportimin më duket të përcaktuar nga kodi nga aktet nënligjore. Duhet ta shqyrtojmë?! Dakord. Atëhere, KAS vendosi:

- pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Martin Dodi Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Fier. Seanca për shqyrtimin do të jetë nesër në datë 28.02.2023, ora 13:00. Mbyllim këtë seancë të shqyrtimit paraprak këtu.

Vendimi nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

27.02.2023

Ora 12:34

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 08 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S’ka prezent

Z. E. Çefa: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 8. Kjo kërkesë i përket propozimit për marrjen e masës administrative gjobë në masën 10,000 lekë ndaj zonjës Dhurata Gjoka me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës. Sipas shortit të hedhur në KQZ, do të jem unë Elvis Çefa relatori i kësaj çështje, verifikojmë prezencën e palëve. Pas pranisë së KAS-it është prezent Sekretari i Përgjithshëm i cili përfaqëson Komisionerin Shtetëror në gjykim administrativ dhe administrata e KQZ-së. Deklaratë nga kolegët për konflikt interesi për këtë rast nuk ka kështu që nuk kemi pengesë për të vazhduar vlerësimin duke i dhënë fjalën Sekretarit të Përgjithshëm për të parashtruar shkurtimisht pretendimet e Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Gjatë periudhës së monitorimit datë 24 janar deri më 2 shkurt 2023 Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së 19

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

veprimtari jasht afatit ligjor të parashikuar nga neni 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Gjatë hetimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar se këto veprimtari janë veprimtari që përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Durrës ka shkelur detyrimin ligjor për mosraportimin brënda afatit të parashikuar në ligj. Në keto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative më gjobë në masën 10,000 lek për Drejtorin e Drejtoris së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ konstatohet se është, plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes të nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 130 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte administrata kërkon që çështja të kalojë për shqyrtim. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Faleminderit! Një sqarim, pra nga hetimi administrativ i Komisionerit ka rezultuar në fund, që vetëm 6 nga aktivitetet për të cilat ka filluar hetimi administrativ plotësojnë kushtet për të ndërmarrë sanksion administrativ ndaj personit. Apo jo? Pra vetëm për 6?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. E. Çefa: Pjesa tjetër janë konsideruar që nuk kanë elementë të shkeljes së ligjit. Ndonjë pyetje nga kolegët? Nuk ka!
Atëherë meqenëse elementët formalë plotësohen... Po Zoti Braho!

Z. L. Braho: Dhe këtu Ylli do të na duheshin këto raportimet për secilin. Edhe nëqoftëse ka ndonjë interpretim për këto aktivitetet që nuk janë konsideruar si

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

publike ose prova përkatëse. Besoj hetimi administrativ ka pasur edhe prova përderisa Komisioneri ka dalë në këtë përfundim.

Z. Y. Merkaj: Patjetër do ta plotësojmë dosjen. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Atëherë meqenëse elementët formal sikurse thashë të nenit 126 dhe nenit 130 të kodit plotësohen mendoj që ta kalojmë në seancë. Kolegët janë dakord? Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi:

- pranimin dhe kalimin për shqyrtim të kërkesës numër 8 të Komisionerit.

Duke marrë në konsideratë faktin që bëhet fjalë për të njëjtin person ndaj të cilit propozohet marrja e masës administrative edhe në kërkesën numër 5 të Komisionerit, KAS vendosi gjithashtu:

- bashkimin e këtyre dy çështjeve.

Pra kjo, kërkesa numër 8 do të bashkohet me kërkesën numër 5 dhe relator do të ngelet kolegu Bele. Data e seancës është përcaktuar për nesër në orën 12:30. Faleminderit! Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 11 dhe 14

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

27.02.2023

Ora 12:39

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për pranim për shqyrtim të kërkesës nr. 09 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zonjës Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme, Bashkia Berat””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S’ka prezent

Z. E. Lako: Atëhere çelim seancën e KAS për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës numër 9 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt kërkesë për vendosje të sanksionit administrativ ndaj zonjës Arisa Toska Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Berat. Sipas nenit 129 të Kodit Zgjedhor relator i kësaj çështje jam zgjedhur unë, Elvin Lako. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vërejmë se nuk është paraqitur zonja Toska as ndonjë palë e interesuar. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm për plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së kësaj çështje, 2 fjalë.

Z. Y. Merkaj: Po, faleminderit! Gjatë periudhës së monitorimit datë 24 janar deri më 2 shkurt 2023 Bashkia Berat ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së 5 veprimtari jasht afatit ligjor të parashikuar nga neni 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Gjatë shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar se

Zbardhi materialin audio

Jong DERVISHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

këto veprimtari janë veprimtari që përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Berat ka shkelur detyrimin ligjor për mosraportimin brënda afatit të parashikuar në ligj. Në keto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative më gjobë në masën 10,000 lek për Sekretarin e Përgjithshem të Bashkisë Berat si personi përgjegjës që ka detyrimin të bëj raportimin në ndërfaqen e KQZ-së. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ konstatohet se është, plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes të nenit 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Ju faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar. Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Dakord! KAS-i i konsultuar në vënd konstatoi që janë plotësuar kërkesat e neneve 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor kështuqë në këto kushte vendosim kalimin për shqyrtim të kësaj çështje. Do ta vazhdojmë me ty më duket me gjashtë?! Dhe meqenëse kemi të bëjmë me të njëjtin objekt dhe subjekt të përcaktuar edhe në kërkesën ankimore të paraqitur nga Komisioneri numër 6, KAS-i vendosi që kjo çështje të bashkohet me kërkesën ankimore numër 6 dhe të shqyrtohen të dyja bashkarisht në seancën e datës 28 shkurt në orën 12:45. Me këtë e deklarojmë të mbyllur këtë seancë. Faleminderit!

Vendimi nr. 12, 15

Zbardhi materialin audio

Jona DERVISHI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

27.02.2023
Ora 12:42

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për pranim për shqyrtim të kërkesës nr. 10 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj Sekretarit të Përgjithshëm, Bashkia Roskovec””.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** S’ka prezent

Z. K. Bele: Vazhdojmë me kërkesën numër 10, lidhet me Bashkinë Roskovec. Sipas shortit të hedhur, relator jam unë Koli Bele. Të pranishëm anëtarët. Nuk rezulton të ketë ndonjë deklaram për papajtueshmëri. Duke qenë se jemi në elementët e formës ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të bëjë një paraqitje të shkurtër.

Z. Y. Merkaj: Gjatë periudhës së monitorimit datë 24 janar deri më 2 shkurt 2023 Bashkia Roskovec ka raportuar në ndërfaqen e raportimit të KQZ-së 3 veprimtari jasht afatit ligjor të parashikuar nga neni 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Gjatë shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nisur nga tematika e veprimtarisë ka vlerësuar se këto veprimtari janë veprimtari që përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Roskovec ka shkelur detyrimin ligjor për mosraportimin brenda afatit të parashikuar në ligj. Në keto kushte Komisioneri Shtetëror i

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.02.2023*

Zgjedhjeve i ka propozuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative më gjobë në masën 10,000 lek për Sekretarin e Përgjithshëm të Bashkisë Roskovec si personi përgjegjës që ka detyrimin të bëj raportimin në ndërfaqen e KQZ-së. Nga verifikimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksionit administrativ konstatohet se është, plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes të nenit 126 i Kodit Zgjedhor dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Në këto rrethana administrata kërkon kalimin e kërkesës për shqyrtim nga KAS-i. Ju faleminderit!

Z. K. Bele: KAS vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancën publike të datës 28 shkurt në orën 13:15.

Vendimi nr. 13

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

